



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 4 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas lëndës me vetë iniciativë të KSHPK-së (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 72-të, të mbajtur më 29.07.2022, morri vendimin vijues:

### Vendim

Procedura në lëndëm me nr. 09-948/1 i 01.03.2021, i formuar me vetiniciativë kundër personit -----, U.D. Drejtor i NP -----, **NDËRPRITET.**

Pas miratimit të Vendimit për shkelje të dispozitave nga LPKKI, Procesverbali për shkelje të konstatuar me urdhërpagesë për kundërvajtje ndaj personit ----- dhe veprimeve të tij, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 09-948/1 nga 01.03.2021 e formuar me vetiniciativë, në pajtim me nenin 17 paragrafi 1 pika 10 dhe 12 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, sipas të cilit Komisioni Shtetëror evidenton dhe monitoron gjendjen pasurore dhe interesat dhe kontrollon të dhënat nga deklaratat e dorëzuara për gjendjen dhe interesat pasurore.

KSHPK ja realizoi kontroll në formularin e dorëzuar për konflikt të interesave nga ana e personit ----- me nr. 09-1329/1 të datës 21.02.2020, pas emërimit në postin UD drejtor në NP-----, menaxhoi si pronar me shoqërinë tregtare ----- që është në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave që përbën shkelje të dënueshme sipas nenit 105 paragrafi 1 alineja 2 të ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

KSHPK konstatoi se nga personi /// është kryer shkelje dhe për të njëjtën gjë sipas Ligjit për kundërvajtje ka hartuar procesverbal të shkeljes së konstatuar dhe ka lëshuar një urdhër pages për kundërvajtje, të cilat janë dorëzuar në aneks.

KSHPK i tregoi të njëjtit person se është e nevojshme në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të vendimit të theksuar, menaxhimi me shoqërinë tregtare -----t'ia beson personit ose trupit tjetër, përveç anëtarve të familjes së tijë.

Në afatin e parapar me ligj, personi i emëruar veproi sipas kërkesës së KSHPK-së dhe realizoi ndryshim në menaxhim e shoqërisë tregtare ----- pas së cilës u emërua një person tjetër për menaxhues,----- . U doërzua provë për të theksuarën, Aktvendim nga Regjistri Qendrorë të RMV-së për regjidtrim të kryer të ndrishimit të datës 20.05.2021

Gjithashtu, personi /// në KSHPK dorëzoi fletëpagesën për gjobën e paguar pas urdhër pagesës së lëshuar për kundërvajtje me numër //// të datës 16.09.2021.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHТETЁRORE  
PЁR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar,  
Nuri Bajrami

Pas përfundimit të seancës së KSHPK-së  
Përgatiti: K.Z., Udhëheqëse  
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

